



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 147 , Datë, 10.09.2020

“MBI
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2020”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, nr.99/4 prot datë 03.09.2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin Gusht 2020,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sha., me shkresën e saj nr.7048 prot, datë 31.08.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike për muajin Gusht 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i mundësisë së fundit.
- Bashkëlidhur këtij aplikimi, FSHU sha., ka dërguar edhe raportin mbi zhvillimin e procedurës së blerjes së energjisë për muajin Gusht 2020.
- FTL sh.a. ka realizuar dy procedura blerje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të "Operatorit të sistemit të shpërndarjes" sh.a. dhe "Furnizuesit të shërbimit universal" sh.a., për periudhën 01.08.2020 - 31.08.2020.
- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike prej 5.505 Lekë/kWh i konvertuar me kursin e këmbimit të datës 29 Korrik në të cilën është realizuar procedura e parë e blerjes së energjisë nga FTL sha korespondon me çmimin mesatar të ponderuar të të dy procedurave të realizuara nga FTL sh.a. prej 44.44 Euro/MWh ($44.44 * 123.88 = 5505$ Leke/MWh ose 5.505 Leke/kWh).

- Sasia prej 74,684 MWh (siç deklaruar në aplikim) është përdorur nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojave të saj, ndërsa diferenca prej 62,956 MWh është përdorur për mbulimin e humbjeve në rrjet të OSSH sha.,
- Për përlllogaritjen e çmimit mesatar të blerjes së energjisë i referohemi kursit të këmbimit të datës 29 për sasinë prej 43,896 MWh dhe për sasinë e mbetur prej 30,788, kursit të këmbimit të datës 30 korrik sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”, është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020”, është 1.5 lekë/kWh.
- Në zbatim të “Metodologjisë të përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sha., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Gusht 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Gusht 2020

Gusht 2020		Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	5.505
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.17</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhen relevante	Leke/kWh	5.67
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	9.71

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sha., si dhe vlerësimeve të ERE sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Gusht 2020, të jetë 9.71 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i mundësisë së fundit prej 9.71 Lekë/kWh për muajin Gusht 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI